

SHTATOR 2013

# RAPORTI I PROGRESIT PËR MARRËVESHJEN KOMPAKTE



BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR SUNDIM TË LIGJIT



# FJALA HYRËSE

Kosova është duke shkuar në mënyrë të vendosur në rrugën e saj drejt BE-së. Duke marrë parasysh nevojën për një ekspertizë evropiane në fuqizimin e Institucioneve të reja të Kosovës, të gjithë akterët e BE-së vazhdojnë të përkrahin rrugën e Kosovës drejt BE-së. Në qershor të vitit 2013, Këshilli Evropian mori një vendim historik për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën.

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit janë kushte të domosdoshme për pranim në BE. Vetëm institucione të fuqishme dhe të qëndrueshme mund të vendosin në mënyrë efektive standardet e sundimit të ligjit të cilat do të shtrojnë rrugën për zhvillim dhe rritje ekonomike.

Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar t'i ndihmojë Kosovës në këtë përpjekje. Prandaj, në nëntor të vitit 2012, ne, bashkërisht, nënshkruam Kompaktin i cili përmbledh objektivat e përbashkëta për sundimin e ligjit. Kjo përbënte një përpjekje ambicioze duke shënuar kështu një lloj të ri të partneritetit dhe përgjegjësisë. Që nga atëherë, ne kemi punuar së bashku për përmirësimin e legjislacionit dhe fuqizimin e institucioneve për të siguruar përparim drejt qëndrueshmërisë, llogaridhënies dhe për t'i ndihmuar institucionet për sundim të ligjit të mos jenë të ndikuara politikisht.

Kompakti nuk zëvendëson angazhimet tjera të rëndësishme siç janë Procesi i Stabilizim-Asociimit dhe Dialogu për Liberalizimin e Vizave. Ky, në fakt i mbështet këto procese. Është e rëndësishme për të gjithë ne që progresi të vlerësohet rregullisht në bazë të treguesve të identifikuar objektivisht. Për këtë qëllim ne kemi hartuar Mekanizmin për Vlerësimin e Kompaktit në mënyrë që të përcjellim progresin së bashku. Mundësia për të vlerësuar progresin e përgjithshëm të arritur paraqet një gurthemel në partneritetin në mes BE-së dhe institucioneve të Kosovës duke paraqitur dëshmi të fuqishme për një punë të madhe të bërë në arritjen e objektivave të përbashkëta të sundimit të ligjit.

Transparenca dhe llogaridhënia janë njëlloj të rëndësishme. Ne qëndrojmë të përkushtuar për të informuar publikun për punën tonë të përbashkët e cila vlerësohet vazhdimisht. Për këtë arsye, jemi të kënaqur të paraqesim raportin e parë për progresin e Kompaktit.

Objektivat e paraqitur në dokumentin e Kompaktit mbesin prioritet. Ne e ritheksojmë përkushtimin dhe përpjekjet tona të plota përfshirë angazhimin e të gjitha resurseve të nevojshme për të arritur qëllimet ambicioze të definuara në Kompakt në muajt në vijim.

Zëvendës Kryeministri  
i Kosovës/ Ministri i Drejtësisë  
**Hajredin Kuçi**

Përfaqësuesi Special i BE-së në  
Kosovë/ Shefi i Zyrës së BE-së  
në Kosovë  
**Samuel Žbogar**

Shefi i Misionit  
të EULEX-it në Kosovë  
**Bernd Borchardt**



# HYRJE DHE HISTORIKU

## KOSOVA DHE BE-JA - PARTNERITETI NË REFORMAT E SUNDIMIT TË LIGJIT

Kosova dhe BE-ja kanë bërë që sundimi i ligjit të jetë prioritet në marrëdhëniet mes tyre. Zhvillimet në këtë fushë janë të rëndësishme në proceset integruuese të Kosovës drejt BE-së. BE-ja përdor mënyra të ndryshme për të mbështetur rrugën e Kosovës për në BE. Kanë filluar procese të ndryshme në këtë aspekt siç janë Dialogu i Strukturuar për Sundimin e Ligjit, Dialogu për Liberalizimin e Vizave dhe Dialogu për Procesin e Stabilizim-Asociimit. Kompakti ndihmon të gjitha këtë procese. Prandaj, ky Raport i cili përqendrohet në implementimin e Kompaktit duhet të interpretohet bashkë me dokumentet tjera për matjen e progresit të institucioneve të Kosovës për sundim të ligjit në rrugën e tyre drejt arritjes së institucioneve të pavaruara, shumëetnike dhe të pandikuara politikisht, respektimin e të drejtave të njeriut dhe për t'iu përmbajtur standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane.

Ky raport ka për qëllim të informojë publikun e gjërë lidhur me mekanizmat e ngritur për të arritur këto objektiva dhe përmes tyre, arritjen e rezultateve.

### KOMPAKTI

Më datën 9 nëntor të vitit 2012, Zëvendës Kryeministri i Kosovës dhe Ministri i Drejtësisë, Përfaqësuesi Special i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë nënshkruan Kompaktin. Kompakti është një dokument udhëzues përmes të cilit autoritetet e Kosovës, PS i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe EULEX-i zyrtarisht janë përkushtuar që të punojnë bashkërisht drejt realizimit të një sërë objektivash për sundimin e ligjit. Kompakti është një 'chapeau' i cili





përmbledh prioritetet e sundimit të ligjit dhe një numër të ashtuquajturave 'Kompaktveprimeve' që shtjellojnë në hollësi aktivitetet specifike dhe qëllimet konkrete të cilat përkrahin proceset aktuale në mes të BE-së dhe Kosovës, përfshirë kushtet për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim -Asociimit dhe Dialogun për Liberalizim të Vizave. Ndaj, kushtet e përgjithshme për pranim në BE dhe prioritetet e EULEX-it, PS të BE-së /Shefit të Zyrës së BE-së në Kosovë, dhe Insitucioneve të Kosovës për sundim të ligjit janë të sinkronizuara përmes Kompaktit.

Nënshkrimi i Kompaktit ishte një sinjal i qartë për ripërtirjen dhe fuqizimin e partneritetit, duke garantuar kështu një bashkërendim të ngushtë në mes të akterëve dhe një përkushtim të përbashkët për të punuar brenda kornizës së përgjithshme politike të BE-së dhe në përputhje me mandatin e EULEX-it. Nënshkruesit poashtu janë zotuar të angazhojnë resurset e nevojshme për realizimin e qëllimeve të parapara në dokumentin e veprimeve të Kompaktit. Që nga ajo kohë Kompakti ka ndihmuar në drejtimin e përpjekjeve tona të vazhdueshme për reformimin e institucioneve për sundim të ligjit në Kosovë duke ofruar një kornizë të përbashkët operacionale si dhe duke përcaktuar aktivitetet të cilat duhet të kryhen brenda një afati të paraparë kohor që përkon me përfundimin e mandatit aktual të EULEX-it në qershor të vitit 2014.

## **BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR SUNDIMIN E LIGJIT**

Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL) organ i bashkëkryesuar nga Zëvendës Kryeministri i Kosovës dhe Ministri i Drejtësisë, Përfaqësuesi Special i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë, është forumi kryesor për të diskutuar tema të përbashkëta lidhur me sundimin e ligjit dhe për të mbikëqyrur zbatimin e Kompaktit. Bordi bënë vlerësimin e rregullt të progresit të arritur në implementimin e veprimeve të Kompaktit. Ky organ është zhvilluar në këtë rol si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të harmonizuar iniciativat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në mes të familjes së BE-së dhe institucioneve të Kosovës për sundim të ligjit. Pjesëmarrës në BPBSL janë Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës,

Ministri i Financave and Ministri për Integritet Evropian si dhe Përfaqësuesi Special i BE-së/ Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe pjesëtarë të EULEX-it. Për më tepër, kryesuesit mund të ftojnë çdo person pjesëmarrja e së cilit në takim mund të jetë e dobishme për diskutim, në veçanti kryesuesit e institucioneve të pavarura të sundimit të ligjit dhe agjencive për zbatim të ligjit, siç janë kryesuesit e Këshillit Gjyqësor dhe të atij të Këshillit Prokurorial, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave të Kosovës, Kryesuesin e Agjencionit Antikorrupsion dhe Komisionerin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Bordi mbështetet nga një sekretariat i përbashkët i BPBSL-së i përbërë nga stafi i cili caktohet nga të tre kryesuesit. Sekretariati përgatit takimet dhe dokumentet e BPBSL-së dhe siguron mbarëvajtjen e nevojshme të punës.

## **ZHVILLIMET NGA NËNTORI 2012 DERI NË GUSHT TË VITIT 2013**

Institucionet e Kosovës të mbështetura nga Përfaqësuesi Special i BE-së/ Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe EULEX-i, kanë punuar mjaft gjatë kësaj periudhe për të arritur përparim në zbatimin e veprimeve të Kompaktit. BPBSL është takuar vazhdimisht për të rishikuar progresin. Bordi është pajtuar për krijimin e një Mekanizmi për Vlerësimin e Kompaktit si mjet vlerësues bazuar në fakte qëllimi i së cilit është të bëjë matjen e progresit kundrejt rezultateve të pritura të përcaktuara në Veprimet e Kompaktit. Pjesët përkatëse të tij bashkëhartohen nga ana e ekspertëve të Kosovës dhe atyre të EULEX-it.

Për disa fusha të caktuara janë zhvilluar tregues të hollësishëm si për përpjekjet kundër korrupsionit dhe për adresimin e krimeve ndër-etnike. Këta tregues azhurnohen bashkërisht nga ekspertë të autoriteteve të Kosovës dhe EULEX-it për të paraqitur një pasqyrë të detajuar të anëve pozitive dhe mangësive në këto dy fusha në mënyrë që kryesuesit e BPBSL-së të mund të informohen mire lidhur me fushat të cilat kërkojnë vendimet e tyre.

BPBSL gjithashtu ka hartuar një numër udhërrëfyesish me qëllim të përpilimit të planeve të detajuara të punës gjatë muajve në vijim për të garantuar institucione vendore të sundimit të ligjit plotësisht funksionale dhe me kuadro plotësisht të angazhuara marrë parasysh një largim të mundshëm të organizuar të rolit të EULEX-it në disa fusha të caktuara.

\*\*\*

Në bazë të të gjeturave të Mekanizmit për Vlerësimin e Kompaktit, ky raport është botimi i parë i BPBSL-së, qëllimi i së cilit është të paraqesë rezultatet e përpjekjeve të koordinuara ndërmjet Institucioneve të Kosovës dhe familjes së BE-së dhe progresin e vlerësuar në raport me objektivat që përfshijnë periudhën kohore nga nëntori i vitit 2012 deri në gusht të vitit 2013.

# RAPORTI I PROGRESIT PËR MARRËVESHJEN KOMPAKTE

Shtator 2013

Partneriteti i familjes së Bashkimit Evropian dhe Kosovës në kuadër të sundimit të ligjit përfshin një numër të madh të fushave, disa nga të cilat janë komplekse dhe teknike. Vetëm marrëveshja Kompakt parasheh 24 veprime, secila prej tyre reflekton disa rezultate dhe tregues të pritshëm. Seksionet në vijim grupojnë aktivitetet në baza tematike, dhe ofrojnë një pasqyrë të përmbledhur të gjendjes aktuale të marrëveshjes Kompakt. Ky raport nuk synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të asistencës së BE-së që jepet në Kosovë. Nëse jeni të interesuar të shihni në më shumë detaje Veprimet e marrëveshjes së Kompaktit në fushën e sundimit të ligjit, luteni të shihni Mekanizmin Përcjellës të Marrëveshjes së Kompaktit, i cili përditësohet rregullisht dhe është i disponueshëm në faqen e internetit të EULEX-it.

## 1. POLICIA & DOGANA

### OBJEKTIVAT

- Zhvillimi i Njesisë së Policisë Rajonale të Kosovës për Mbështetje Operative (ROSU), me fokus në llogaridhënie, shqetësimet për sigurinë e pakicave etnike dhe bashkëpunim efektiv mes palëve të interesit
- Sigurimi për përfundimin e masave për ngritjen e institucionit të Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe respektimin e plotë të rekomandimeve të IPK-së nga ana e Policisë së Kosovës
- Zbatimi i mëtutjeshëm i Planit Strategjik për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (PSSTIK)
- Fuqizimi i shtyllës administrative të PK
- Fuqizimi i kapaciteteve të PK në ofrimin e shërbimeve policore në komunitet
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional mes PK dhe Zyrës së Prokurorit Publik (ZPP)
- Instalimi i skemës për mbrojtjen e dëshmitarëve (SMD) për Kosovës në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD)
- Zhvillimi i partneritetit mes PK dhe Njesisë për Hetime Financiare (NJHF) për luftimin efektiv të krimeve financiare
- Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhim kufitar në kuadër të Doganës së Kosovës dhe Policisë Kufitare të Kosovës
- Propozimi i plotësim-ndryshimeve teknike në ligjet për procedurat e imigrimit





## AKTIVITETET DHE REZULTATET

**Njësia për Mbështetje Operative e Policisë së Kosovës:** Fokusi është përqendruar në proceset e rekrutimit në NJMO dhe centralizimin e menaxhimit të tij për të bashkërenduar më mire aktivitetet në terren. Pranimi i zyrtarëve të ri në NJMO është duke u zhvilluar tani e disa muaj. Dy qëllimet kryesore janë tërheqja e një numri sa më të madh të mundshëm të aplikuesve dhe sigurimi i një përfaqësimi të barabartë etnik përbrenda Njesisë – e që paraqet kushtin kryesor për operim efektiv në të gjitha regjionet e Kosovës. Testet fizike, intervistat dhe verifikimet e kandidatëve janë kryer për 143 kandidatë gjithnjë sipas procedurave standarde të operimit që janë në fuqi. Janë ndërmarrë iniciativa për të inkurajuar aplikimin nga mesi i komuniteteve jo shumicë. Nuk janë shënuar rezultate të konsiderueshme: nga 143 kandidatë, vetëm njëri nga ata i takonte komunitetit jo shumicë. Zyrtarët përkatës nga EULEX dhe PK propozuan një tabelë të re organizative e cila parasheh një toger përgjegjës për NJMO-të në Prishtinë dhe Mitrovicë, i cili është llogaridhënës në Drejtorinë e Njësive të Specializuara.

**Inspektorati Policor i Kosovës:** Buxheti i IPK për 2013 ishte dyfishim i buxhetit që kishte në vitin 2012; aktualisht ky buxhet është një milion euro. IPK ka rekrutuar 15 zyrtarë, duke shtuar numrin e hetuesve në 70 - sa kohë që edhe kapaciteti i plotë i planifikuar i IPK është 92 hetues deri në vitin 2015. Nga 15 udhëzime administrative të parapara me Ligjin për IPK (të miratuar në nëntor 2010) janë përpiluar pesë deri tani dhe të cilat po presin miratimin e Ministrit të Punëve të Brendshme. IPK ka pranuar 469 ankesa në

periudhën mes janarit-gushtit 2013; 127 prej tyre janë pasuar me hetime për vepra penale dhe 342 janë shqyrtuar si raste disiplinore dhe janë përcjellë në Njësinë për Standarde Profesionale në PK. Nga ky numër, janë proceduar 52 raste penale të cilat janë përcjellë tek prokurorët përgjegjës. Hetimi i 75 rasteve penale është akoma duke u zhvilluar. Plani për Hetime për 2013 është duke u finalizuar. EULEX këshilloi menaxhmentin e IPK që inspektimi i Shtyllës së PK 'Shërbimet e mbështetjes dhe furnizimit' duhet kryesisht të fokusohet në Drejtorinë për Prokurim, Financa dhe Procedura të Tenderit në Policinë e Kosovës.

**Plani Strategjik për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në PK:** PSSTIK mundëson ruajtjen e informative për resurset njerëzore, financat dhe logjistikën- përmes Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës – për mbledhjen e të dhënave hetimore. PSSTIK mbështetet në një softuer specifik i cili u mundëson zyrtarëve të PK të marrin informacionin që u duhet. Programet e nevojshme është dashur të tenderohen dhe të testohen përgjatë një periudhe provuese. Disa aplikacione të PSSTIK tashmë janë në përdorim dhe progresi në zbatimin e tyre është në përputhje me rezultatet e pritura, respektivisht PSSTIK-un plotësisht funksional deri në qershor 2014, ashtu siç është paraparë.

**Shtylla administrative e PK:** prokurimi i mallrave dhe pajisjeve të nevojshme për operacionet e PK është zhvilluar përmes një bashkëpunimi intensiv të EULEX-it dhe PK. Procedurat e tenderimit janë vlerësuar nga ekspertët e EULEX-it; 15 procese të prokurimit me përmbi 10,000 Euro dhe katër të tjerë nën këtë prag janë monitoruar nga EULEX-i në periudhën mes nëntorit 2012 dhe qershorit 2013. Të gjitha këto dosje janë vlerësuar të jenë në përputhje me ligjin.

**Shërbimet policore në komunitet:** Këshillat Komunale për Siguri në Komunitet (KKSK) janë organe konsultative të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 08/2008 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, i cili inkurajon zyrtarët komunal, PK dhe organizatat e shoqërisë civile të diskutojnë dhe adresojnë çështjet e sigurisë lokale. Të dhënat e disponueshme tregojnë një pjesëmarrje prej 95% të PK në të gjitha takimet e raportuara të KKSK. Modulet speciale për shërbimet policore në komunitet janë inkorporuar në trajnimet bazike policore në akademi, përfshirë edhe modulën e trajnimit për nivelin e menaxhmentit. Në këto programe trajnimi të mbajtura në nivel rajonal kanë marrë pjesë 3,600 zyrtarë policor.

**Bashkëpunimi PK-ZPP:** puna në këtë pikë është e strukturuar përmes dy linjave të aktiviteteve: qartësimi i vazhduar i ndarjes së detyrave sipas obligimeve ligjore, dhe përmirësimi i marrëdhënieve



të punës mes prokurorëve dhe zyrtarëve policorë. Sa i përket ndarjes së detyrave, miratimi i Strategjisë për Bashkëpunim Ndër-Institucional lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), përbën një hap të rëndësishëm përpara; zbatimi i saj është vet fokusi i përpjekjeve aktuale të PK/EULEX-it. Në anën tjetër, edhe miratimi i Ligjit të ri të Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi në janar 2013, mundësoi autoritetin e transferimit në kuadër të PK të rasteve të shkeljeve më të lehta. Lidhur me përmirësimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet PK-së dhe prokurorëve, palët janë pajtuar që të organizojnë takime të strukturuar të cilat duhet të mbahen rregullisht ndërmjet shtatë Prokurorive Themelore dhe stacioneve përkatëse të PK-së. Diskutimet e tilla do të përqendrohen në rastet specifike, por orari i tyre ende nuk e ka arritur shpeshtësinë e planifikuar. Bashkërendim duhet të ketë edhe në nivel ministror dhe duhet ta përfshijë Kryeprokurorin dhe Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së në mënyrë që Strategjia për Zvogëlimin e Krimit për Kosovën të drejtohet në mënyrë të harmonizuar si edhe të planifikohet një program i përbashkët trajnimi për hetuesit e PK-së dhe për prokurorët publikë.

**Plani për mbrojtjen e dëshmitarëve:** projekti i financuar nga BE-ja për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Luftën kundër Krimit të Rëndë dhe Terrorizmit (WINPRO) është aktualisht duke përparuar sipas afateve të planifikuara. EULEX-i, WINPRO dhe PK-ja kanë filluar ta krijojnë një skicë organizative për njësinë e ardhshme të mbrojtjes së dëshmitarëve. WINPRO po ashtu në bashkëpunim me EULEX-in do ta zhvillojë një program trajnimi. Në janar 2013 është nënshkruar një marrëveshje teknike për zhvillimin e marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera dhe menjëherë pastaj u mbajt një takim me shtetet anëtare për ta diskutuar mbështetjen e mëtejshme të mundshme. WINPRO është aktualisht duke i zhvilluar kornizat logjistike dhe administrative për mbrojtjen e dëshmitarëve të Kosovës dhe parashikon që ta përfundojë hartimin e akteve të domosdoshme nënligjore dhe udhëzimet administrative deri në shtator 2013.

**Partneriteti PK-NJIF:** NJIF ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me PK-në në shkurt 2013 për ta mbështetur këmbimin e sigurt dhe të shpejtë elektronik të informatave. Pesë njësi të PK-së janë lidhur me softuerin goAML Message Board – i cili mundëson mbledhjen e të dhënave nga të gjitha Njësitë e lidhura për Inteligjence Financiare– dhe tani informatat ndërmjet NJIF dhe PK-së janë duke u këmbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të sigurt.

**Dogana e Kosovës dhe Policia Kufitare e Kosovës:** Plani për Menaxhimin e Doganës së Kosovës/Plani Strategjik 2013-2015 është aprovuar; aktualisht është duke u bërë rishikimi i gjashtë muajve të parë të tij dhe është krijuar një sistem për mbikëqyrjen e përmbushjes që do të zhvillohet edhe më tej me projektin e binjakëzimit të financuar nga BE-ja. Në pajtim me aktivitetet e planifikuara në Strategjinë Nacionale të Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2012-2017, vendkalimi kufitar në Bellanoc-Stançiç është



në fazën e planifikimit, ashtu si edhe dy korsitë e reja në Vërmicë edhe gjashtë vendkalimet e përbashkëta të përhershme të vendosura së bashku me Serbinë. Terminali i ri në Aeroportin e Prishtinës do të hyjë në funksion deri në dhjetor 2013.

Sa ju përket operacioneve të zhvilluara në kuadër të fushëveprimit të Strategjisë Nationale për Krimin e Organizuar dhe Planit të Veprimit, Dogana e Kosovës (DK) ka hetuar një rast të kontrabandës me bagëti në Mitrovicë me Agjencinë Kosovare për Ushqim dhe Veterinari, ndërsa ka kryer edhe një operacion tjetër të përbashkët me EULEX-in në lidhje me barëra në rajonin e Pejës. DK po ashtu ka zhvilluar operacione kundër makinave dhe objekteve të kumarit pa licencë, si edhe dy operacione duke vënë në shënjestër prodhimin dhe shitjen e alkoolit të falsifikuar. Në përgjithësi, DK ka kryer 135 aktivitete të përbashkëta me agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit. Policia Kufitare e Kosovës (PKK) ka kryer 11 operacione të përbashkëta me DK-në dhe tri operacione të përbashkëta me DK-në dhe me Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari. Për më tepër, janë mbajtur dy takime me prokurorin e shtetit dhe janë zhvilluar 22 operacione të përbashkëta ndërmjet DK-së dhe Administratës Tatimore të Kosovës. DK ka kryer 138 operacione kundër kontrabandës. PKK i ka nisur 31 hetime penale për rastet e kontrabandës me imigrantë, prej këtij numri 12 raste tashmë janë mbyllur dhe 19 mbesin të hapura. Prej nëntorit 2012, në lidhje me qëndrimin e paligjshëm PKK ka refuzuar hyrjen në 1,265 raste dhe ka lëshuar 175 urdhra për largim. Sistemi për Menaxhimin e Kufirit (SMK, sistemi elektronik për menaxhimin e vendkalimit kufitar) ka filluar së pari më 2011 dhe ndërsa sistemi funksionon në të gjitha vendkalimet kufitare përfshirë aeroportin, ai ende nuk e ka arritur kapacitetin e tij të plotë të funksionimit meqë disa tipare të tij ende duhet të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Lidhja në internet dhe sigurimi i qëndrueshëm i energjisë elektrike janë parakushte kryesore për funksionimin e SMK dhe standardet ndryshojnë në thelb në vendkalime të ndryshme kufitare.

## 2. DREJTËSIA

### Objektivat

- Ta përmirësojë Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK)
- Ta forcojë kapacitetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK)
- Ta plotësojë mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP)
- Ta përmirësojë përmbushjen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS)
- Ta mbështesë gjykimin e lëndëve civile që kanë të bëjnë me pronën
- Ta zgjerojë bashkëpunimin ndërkombëtar ligjor (BNL)

### AKTIVITETET DHE REZULTATET

**Shërbimi Korrektues i Kosovës:** që nga nënshkrimi i marrëveshjes kompakte, SHKK, në partneritet me EULEX-in, ka qenë duke e vendosur bazën për aftësinë e vetë-inspektimit të shërbimeve të veta duke zbatuar masat e auditimit nga Programi Ndërkombëtar për Auditimin e Standardeve (PNAS). Edhe pse masat nuk janë të vendosura plotësisht, SHKK ka filluar t'i kryejë inspektimet duke u përqendruar në sigurinë dhe operacionet në objektet e tij. Përveç këtyre inspektimeve, auditimi i plotë duhet t'i

përfshijë vlerësimet për legjislacionin, administratën dhe trajtimin e të burgosurve. Ndërmjet muajve janar dhe qershor 2013 janë kryer njëzet e tetë auditime të përbashkëta në të gjitha institucionet korrektuese. Drejtorët dhe zyrtarët për financa të SHKK-së kanë vijuar trajnimin për menaxhimin e financave publike, për kontabilitet dhe kontrole si pjesë e përgatitjes që drejtorët e objekteve të marrin më tepër kontroll lidhur me buxhetet e institucioneve.

Në mënyrë që të tejkalohet kapaciteti i pamjaftueshëm për përcjelljen e të

burgosurve në Mitrovicë, BPBSL e ka ngarkuar SHKK-në me detyrën që, në bashkërendim të ngushtë me EULEX-in, ta hartojë një udhëzim që do ta zbuste mungesën e personelit dhe shqetësimet lidhur me sigurinë. Udhëzimi është hartuar dhe është aprovuar dhe zbatimi i tij ka filluar; një marrëveshje është nënshkruar me Policinë e Kosovës për t'i mbështetur përcjelljet nëse nevojitet të bëhet kjo dhe me rekrutimin e personelit shtesë.



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës:** KPK deri tani është përqendruar në zbatimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, i cili i plotëson ligjet e tjera për reformimin e gjykatës. Për zbatimin e këtij ligji është nevojitur riorganizimi institucional dhe ndryshimet në personel. Përveç ligjeve kryesore që e rregullojnë strukturën dhe organizimin e gjykatave dhe të prokurorisë, KPK-ja ende duhet t'i plotësojë masat e saj për ndërtimin e institucioneve, në veçanti në lidhje me mbikëqyrjen e shërbimeve prokuroriale, përfshirë rregulloret për vlerësimin e përmbushjes për prokurorët. KGJK-ja është duke punuar lidhur me masat e ngjashme, edhe pse është penguar



nga mungesa e dy anëtarëve të saj të cilët kanë mbetur të emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Në gusht 2011 KPK aprovoi rregulloren për procedurat dhe kriteret për vlerësimin e përmbushjes së prokurorëve dhe të prokurorive. Kjo rregullore aktualisht është duke u amadamentuar.

Deri më tani, tre prokurorë janë vlerësuar në bazë të rregullores ekzistuese në vitin 2013. KGJK-ja megjithatë e pati mundësinë për amandamentimin e Rregullores për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe, që nga fillimi i vitit, ka bërë vlerësimin e punës së 12 gjyqtarëve mandati fillestar trevjeçar i të cilëve ka skaduar në maj dhe qershor të vitit 2013, për qëllime të riemërimit. Në vitin 2012, KGJK-ja e ka miratuar planin strategjik pesëvjeçar në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Fondet për këtë ishin siguruar së fundmi dhe ato janë përcaktuar për zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të lëndëve. Sekretariati i KGJK-së i ka caktuar disa zyrtarë ligjorë për ta mbështetur punën e KGJK-së dhe të komisioneve të saj, ndonëse nevojitet më shumë për të siguruar që reforma gjyqësore të zbatohet në mënyrë efektive, që procesi i emërimit të kryhet dhe që të përmbushen obligimet për procesin e integritetit evropian dhe për zbatimin e dialogut.

**Përmbushja e mandatit lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës:** Përmes funksioneve të veta ekzekutive, EULEX-i ofron mbështetje Komisionit të Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP) dhe Panelit për Ankesa të Gjykatës Supreme për çështje të ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) për zgjedhjen e kontesteve të pazgjidhura bujqësore dhe komerciale që kanë dalë prej konfliktit të armatosur të vitit 1998-1999. Deri më tani, prej 42,515 kërkesave që janë paraqitur, 38,495 janë vendosur, ndërsa 580 janë tërhequr prej paraqitësve të kërkesave. Numri prej 3,440 kërkesave të mbetura presin të procesohen prej Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së për referim tek KKKP. Gjendja me staf të pamjaftueshëm në KKKP dhe AKP ishte çështje kritike

gjatë periudhës së verës, por tani ajo çështje është trajtuar nga EULEX-i, së paku për sa i përket stafit ndërkombëtar. Zyra e KKKP tani duhet të gjejë zgjidhje strukturore për gjashtë vendimet përmbledhëse që nuk janë përfunduar pas këtij problemi me numrin e stafit për ta parandaluar ndikimin negativ në përfundimin me kohë të mandatit të KKKP-së meqë kërkesat që kanë mbetur janë duke u bërë më të ndërlikuara dhe kërkojnë shumë kohë. Për këtë arsye, sistemi për përgatitjen e kërkesave është ristrukturuar në mënyrë që sistemi të jetë më efikas dhe të mund të gjendet më shumë kohë për kërkesat që janë më të ndërlikuara. Deri më tani në AKP janë paraqitur 646 ankesa kundër vendimeve të KKKP, ku 353 prej tyre kanë marrë vendime përfundimtare, ndërsa 218 ankesat e tjera janë në pritje të vendimit. Në seancën e Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL), mbajtur në maj të vitit 2013, autoritetet kosovare, në konsultime me palët përkatëse të interesit, u dakorduan lidhur me një udhërrëfyes për angazhimin e mëtejshëm të EULEX-it për çështjet që ndërlidhen me AKP-në, duke u përqendruar në veçanti në finalizimin e punës së gjykimeve të KKKP deri në qershor të vitit 2014 dhe themelimin e një paneli të dytë për ankesa të AKP-së deri në verë të vitit 2013 duke e pasur parasysh gjykimin e pritur të të gjitha ankesave deri në verën e vitit 2016.

#### **Performanca e shtuar e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme:**

Përmes funksioneve ekzekutive, EULEX-i i ofron mbështetje Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS) lidhur me gjykimin e rasteve dhe përmes përmirësimit të kapaciteteve teknike të DhPGjS-së. Të gjitha rastet gjykohen prej paneleve që përbëhen prej gjyqtarëve vendorë dhe atyre të EULEX-it, dhe kjo e promovon bashkëpunimin mes kolegëve përmes shkëmbimit të pikëpamjeve dhe praktikave më të mira. EULEX-i ka zhvilluar indikatorë të cilët mund ta monitorojnë performancën e gjykatës, përfshirë numrin e përgjithshëm të lëndëve që presin të shqyrtohen prej gjykatave, lëndëve të regjistruara dhe lëndëve të zgjidhura, numrin e faqeve të dokumenteve që janë përkthyer dhe normën e përgjithshme të lëndëve të përfunduara. Aktualisht në gjykatë numri i lëndëve që regjistrohen është shumë më i lartë sesa numri i lëndëve që përfundohen (norma e përfundimit të lëndëve është shumë nën 100%, që nënkupton se më shumë lëndë/kërkesa regjistrohen sesa që kryhen), andaj në DhPGjS vazhdojnë të krijohen lëndë të papërfunduara. Sa i përket llojit të rasteve që paraqiten para gjykatës, deri në fund të korrikut 2013, 370 raste kishin të bënin me listat e punëtorëve (të përbëra prej 5,294 ankesave individuale të punëtorëve), 4,406 lloje të tjera të kërkesave për trupin gjykues dhe 414 raste në Panelin e Apelit. Gjatë periudhës së raportimit, numri i lëndëve të pazgjidhura ka vazhduar të shtohet në të gjitha këto fusha, përveç Panelit të Apelit, i cili ka parë një rënie shumë të vogël të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pas rënies së vazhdueshme gjatë disa muajve, përkthimet e papërfunduara në DhPGjS gjithashtu kanë shënuar rritje në korrik të vitit 2013.

Në sesionin e BPBSL-së që është mbajtur në maj 2013, Bordi është dakorduar që ta zhvillojë një udhërrëfyes të përbashkët për funksionalizimin e plotë dhe burime të plota në DhPGjS deri në fund të vitit 2013.

**Gjykimi i lëndëve civile pronësore:** EULEX-i e mbështetë gjyqësorin vendor për gjykimin e lëndëve civile pronësore në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Lëndët që mirren përsipër menjëherë i caktohen një gjyqtari të EULEX-it për lëndë civile sipas listës së brendshme të Njesisë mobile dhe/apo përcaktimit të gjyqtarëve kosovarë. Anëtarët e trupave gjykues të përbërë në rastet e shkallës së dytë kërkohen dhe sigurohen prej Gjykatës së Apelit. Procedurat për marrjen përsipër të lëndëve janë reduktuar në mënyrë të konsiderueshme për sa i përket kohëzgjatjes prej 2-3 muajve në 10 ditë për procesimin e rasteve urgjente. Mes nëntorit 2012 dhe gushtit 2013, janë regjistruar gjithsej 107 kërkesa për marrje përsipër të shqyrtimit të lëndëve, 84 janë vlerësuar në mënyrë juridike, prej të cilave 37 lëndë civile pronësore në 17 gjykata/degë të ndryshme janë parazgjedhur dhe janë marrë përsipër. Mes nëntorit 2012 dhe gushtit 2013, 60 lëndë civile ishin në kuadër të mandatit ekzekutiv të njesisë mobile të gjyqtarëve civilë të EULEX-it: 33 janë përfunduar dhe 27 janë në gjykim e sipër. Siç ishte planifikuar, prioritet i është dhënë rasteve të diskriminimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB): të gjitha 263 referimet e KKPB janë kontrolluar në 19 gjykata, lëndët e regjistruara janë inventarizuar, dhe prej tyre 44 janë parazgjedhur, 12 janë marrë përsipër, dhe katër ishin vendosur. Funksionet ekzekutive gjithashtu janë ushtruar nga njësia mobile e gjyqtarëve të EULEX-it për lëndë civile në 48 raste civile pronësore të ndjeshme, prej të cilave 29 janë përfunduar.

**Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar:** buxheti që i është ndarë Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është rritur në vitin 2013, si reagim ndaj numrit në rritje e sipër të kërkesave për ndihmë juridike reciproke. DBJN është kompetent për sigurimin e bashkëpunimit gjyqësor për çështje penale dhe civile dhe për hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve bilaterale. Marrëveshjet juridike ndërkombëtare që trajtohen prej DBJN mund të ndahen në dy kategori: (1) përgjegjësitë nga marrëveshjet e trashëguara prej Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë dhe (2) marrëveshjet e lidhura me shtetet që e kanë njohur Kosovën. Në mënyrë që të përmirësohet zbatimi i këtyre marrëveshjeve, si dhe të përmirësohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, Prokurori i shtetit i ka caktuar shtatë pika qendrore për adresimin e rasteve që ndërlidhen me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar për çështje penale. Kohëve të fundit KGJK-ja e ka ndjekur praktikën e caktimit të pikave qendrore nëpër gjykatat themelore. Përveç këtyre kategorive të marrëveshjeve, ekziston edhe marrëveshja teknike për ndihmë juridike reciproke mes Ministrisë së Drejtësisë dhe EULEX-it, në bazë të së cilës deri më 20 mars 2013 EULEX-i i ka transmetuar 1713 kërkesa dhe përgjigje për bashkëpunimin juridik mes Kosovës dhe shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën (përfshirë Serbinë). Pas kësaj date, edhe 73 kërkesa të tjera janë transferuar mes Kosovës dhe shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën (përfshirë Serbinë). Në kuadër të dialogut të facilituar nga BE-ja mes Prishtinës dhe Beogradit, më 20 mars 2013 janë krijuar procedura të reja për ndihmën juridike reciproke mes Kosovës dhe Serbisë, dhe që nga atëherë 843 kërkesa janë transmetuar prej Kosovës në Serbi dhe 1 kërkesë prej Serbisë në Kosovë. Nevojitet më shumë punë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërministrrore të punës për të siguruar një rrjedhe të qetë të bashkëpunimit sa i përket kërkesave për bashkëpunim ligjor.





## 3. VERIU I KOSOVËS

### Objektivat

- Vendosja e sundimit të ligjit në pjesën veriore të Kosovës
- Rritja e performances së PK-ës në regjion
- Përmirësimi i standardeve në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë

### AKTIVITETET DHE REZULTATET

**PK-ja në pjesën veriore të Kosovës:** gjatë periudhës raportuese, reduktimi i dëshiruar prej gjashtë për qind i shkallës së krimit të raportuar dhe vrojtuar nuk është arritur në masë të madhe për shkak të rritjes së ndjeshme të sulmeve të dhunshme në atë pjesë, në fillim të vitit. PK-ja, megjithatë, ka treguar një fleksibilitet më të madh në trajtimin e nivelit të rritur të sulmeve. Një gjë e tillë është demonstruar gjithashtu në operacionet e përbashkëta me EULEX-in, siç është operacioni 'gjilpëra', që përfshinte një varg pikash kontrolli gjatë natës, i ndërmarrë nga EULEX-i në bashkërendim me PK-ën, si përgjigje ndaj numrit të vazhdueshëm të incidenteve që përfshinin eksplozivë. PK-ja ende ka nevojë që të përmirësoj metodologjinë e vet të klasifikimit lidhur me trajtimin e krimeve që potencialisht kanë motive etnike.

**Qendra e paraburgimit në Mitrovicë:** rinovimi i qendrës së paraburgimit në Mitrovicë (QPM) ka përfunduar në dhjetor 2012, duke përmbushur kështu një nga kushtet e paraqitura nga Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) që ka të bëjë me kushtet e të burgosurve. QPM-ja vazhdon të vuaj nga mungesa e stafit. EULEX-i dhe QPM-ja ka qenë të dobishëm në sigurimin e financimit nga Qeveria Holandeze për një projekt të ri-integrimit i zbatuar nga një OJQ vendore. QPM-ja është në kontakt të rregullt me shërbimet lokale, duke përfshirë spitalin e Mitrovicës dhe shërbimin e zjarrfikësve.

## 4. ZBATIMI I DIALOGUT

### OBJEKTIVAT

- Në kuadër të kornizës së kompaktit për zyrën e BE-së dhe EULEX-in që t'u ndihmoj autoriteteve kosovare në zbatimin e një sërë marrëveshesh të arritura në dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, duke përfshirë:
  - Regjistrin civil
  - Lirinë e lëvizjes (LeL)
  - Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK)
  - Kontestet Kadastrale

### AKTIVITETET DHE REZULTATET

**Regjistri civil:** palët negociuese, në konsultim me ekspertë nga të dyja palët, janë pajtuar që t'i japin mandatin EULEX-it për t'i certifikuar të gjitha kopjet regjistrave origjinal civil (RC) e të gjitha komunave të Kosovës të cilat aktualisht janë në posedim të autoriteteve të Serbisë. Kopjimi i tyre kryhet nga një organizatë implementuese e financuar nga BE-ja. EULEX-i, menjëherë pas certifikimit të kopjeve të RC-vë i dorëzon ato tek Agjencia e Regjistrimit Civil. Ky proces ka për qëllim t'ju siguroj autoriteteve të Kosovës kopjet të veta të RC në mënyrë që të dhënat e përfshira aty të mund të kontribuojnë në themelimin një regjistri civil në Kosovë i cili do të jetë është plotësisht i besueshëm.

Numri i përgjithshëm i të gjitha kopjeve të certifikuara të RC ka arritur në 6,889 (nga përafërsisht 12,036 të tilla), ku përfshihen komunat si në vijim:



Lipjani me (848), Obiliqi me (264), Fushë Kosova me (219), Glllogoci më (425), Prishtina me (1,013), Podujeva me (1,066), Gjilani me (935), Kamenica me (824), Viti me (726), Novobërda me (67) dhe Ferizaj me (502).

Gjer tani, EULEX-i ia ka dorëzuar zyrtarisht ARC-ës 4,770 kopje të certifikuara të RC për komunat si në vijim: Lipjan (848), Obiliq (264), Fushë Kosovë (219), Glllogoc (425), Prishtinë (1,013), Podujevë (1,066), Gjilan (935), Kamenicë (824) dhe Viti (726). Nga këto, ARC-ja u ka dorëzuar 4,770 kopje të certifikuara të RC komunës së Lipjanit, Obiliqit, Fushë Kosovës, Glllogocit dhe Prishtinës. Këto kopje para se të dorëzoheshin nga ARC-ja tek zyrat lokale për regjistrim civil, janë lidhur në kopje fizike në Prishtinë me financimin e zyrës së BE-së. Dorëzimi është bërë pas përfundimit të regjistrimit për të cilën komunë, puna e përpunimit të RC pritet të përfundoj në mars 2014.

**Liria e lëvizjes:** marrëveshja për lirinë e lëvizjes në kuadër të dialogut u mundëson qytetarëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë që të udhëtojnë lirisht brenda ose përmes territorit të dy vendeve vetëm me një letërnjoftim, apo, në rast të vozitjes, më tabela e regjistrimit (TRA), patent shofer dhe polica të sigurimit. EULEX-i ofron monitorim, mentorim dhe këshillim në



fushën që ka të bëjë me lëshimin e dokumenteve personale si dhe zbatimin e gjithmbarshëm të lirisë së lëvizjes që ndërlidhet me lirinë e udhëtimit (me dokumente përkatëse) brenda ose përmes territorit të Kosovës dhe Serbisë si dhe për regjistrimin e çdo kalimi në Sistemin e Menaxhimit të Kufirit (SMK). Gjer tani, marrëveshja për lirinë e lëvizjes është duke u zbatuar në të gjitha pikat e kalimit në mes të Kosovës dhe Serbisë në jug të lumit Ibër, kjo përfshin pikat në vijim: Merdarë (ish Porta 3), Mutivodë (ish Porta 4), Dheu i Bardhë (ish Porta 5), Muçibabë (ish Porta 6).

Sipas marrëveshjes për liri të lëvizjes, pronarëve të veturave që banojnë në Kosovë u lejohet që të bartin vetëm regjistrimet me RKS ose KS. Prandaj, Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës (MPB) jo vetëm që ka zgjatur politikën e regjistrimit të veturave me tabela KS por njëkohësisht ka promovuar një politikë që u mundëson pronarëve të veturave që kanë tabela të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë apo Serbisë të regjistruara ndërmjet 10 qershorit 1999 dhe 31 tetorit 2011 t'i ri-regjistrojnë ato në tabela RKS ose KS. MPB-ja ka zgjatur tri herë afatin fillestar deri më 1 qershor 2012, në mënyrë që t'i përmbush kërkesat që vijnë nga pronarët e veturave të cilët përfitojnë nga kjo politikë. Aplikacionet për tabela RKS dhe KS i janë dorëzuar një komisioni ad-hoc i themeluar nga MPB-ja, i cili, pas shqyrtimit të tyre, përmes Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar të EULEX-it, i ka përcjellë të gjitha dosjet tek Byroja Kombëtare e INTERPOL-it në Beograd për verifikim të nevojshëm. Deri tani, nuk është marrë ndonjë informacion nga Beogradi lidhur me statusin e këtyre rasteve. Ndërkohë, MPB-ja për aplikuesit ka lëshuar LQA të përkohshme të vlefshme për një vit, të cilat në pritje të përgjigjes nga Beogradi, janë vazhduar deri në qershor 2014. Prej datës 1 nëntor 2011 e deri më 31 maj 2012, 8,413 pronarë të tabelave të regjistrimit të ish-RFJ-së, Serbisë ose të tabelave KS i kanë vazhduar ose i kanë ndërruar tabelat prej KS në RKS: 3,251 automjete janë regjistruar ose u janë vazhduar tabelat KS, ndërsa 5,161 automjete janë regjistruar me tabela RKS. Ndërmjet datës 1 qershor 2012 dhe datës 28 shkurt 2013, janë pranuar 2,163 aplikacione dhe ato duhet të verifikohen. Prej këtyre aplikacioneve, 2,056 janë pajisur me LQA të përkohshme. Prej datës 1 gusht 2013 në Kosovë janë në qarkullim 262,993 automjete me tabela RKS duke përfshirë këtu automjetet me tabela të përkohshme dhe 7,932 automjete me tabela KS.

Kontejnerët me zyra për sigurimin e automjeteve janë vendosur në pikë-kalimet kufitare në veri në Jarinjë dhe Bërnjak, por ato ende nuk janë në përdorim. SMK është plotësisht funksional në të dyja pikë-kalimet kufitare të cilat janë të pajisura me tri stacione kompjuterike të SMK për futjen e të dhënave për aktivitetet e brendshme dhe të jashtme.

**Menaxhimi i Integruar i Kufirit / Kufirit administrativ:** marrëveshja e Menaxhimit të Integruar për pikë-kalimet (MIK) synon që gradualisht të themelojë poste të përbashkëta, të integruara dhe të sigurta në të gjitha pikë-kalimet e MIK ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në të cilat zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet për të gjitha shërbimet (polici, doganë, kontrollimet e ushqimit dhe të veterinarsë etj.).

Pikë-kalimet e MIK përfshijnë pikat Jarinjë (ish Porta 1), Merdarë (ish Porta 3), Mutivodë (ish Porta 4), Dheu i Bardhë (ish Porta 5), Muçibabë (ish Porta 6), dhe Bërnjak (ish Porta 31). Zyrtarët e EULEX-it janë prezent në të gjitha pikë-kalimet dhe Misioni është duke e luajtur një rol aktiv në kuadër të Grupit për Implementimin e Marrëveshjes për MIK. Të gjitha pikë-kalimet kufitare janë hapur dhe zyrtarët doganor të EULEX-it dhe të Policisë kufitare të EULEX-it vazhdimisht caktohen në të gjitha pikë-kalimet kufitare.

Marrëveshja është arritur nga të dyja palët për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nivelin e trafikut në Merdarë dhe Mutivodë, për të siguruar që burimet adekuate të jenë të disponueshme dhe që të implementohen procedurat për kontrollimin e lehtësuar të trafikut me qëllim të lehtësimit të lëvizjes së udhëtarëve gjatë sezonit të verës. Të dyja delegacionet u pajtuan që duhet të ketë një fushatë informuese për të informuar udhëtarët për rritjen e kohës së pritjeve në Merdarë dhe për mundësinë e përdorimit të pikës në Mutivodë si alternativë. Drejtori i Doganës së Kosovës tashmë është pajtuar që të caktojë zyrtarë doganorë në Mutivodë, sipas kërkesës, dhe hapësira shtesë për kontroll, dhe ka lëshuar një komunikatë për shtyp me të cilën opinioni informohet për hapjen e pik-kalimeve në Muçibabë dhe Mutivodë. EULEX-i vazhdon të jetë anëtar aktiv në takimet e Grupit për Implementimin (GI) e Marrëveshjes së MIK, duke marrë pjesë në të gjitha takimet e mbajtura në Prishtinë, Beograd dhe Bruksel. Në terren, Grupet Punuese Teknike Trepalëshe (GPT) vazhdojnë të bëjnë vizita nëpër të gjitha gjashtë pik-kalimet me qëllim të vlerësimit të gjendjes aktuale në kuptim të infrastrukturës. Të gjitha çështjet e mbetura i raportohen GI për veprime të mëtejme, sipas kërkesës.

Vendosja e Sistemit për Shkëmbim Sistemik të të Dhënave Elektronike (Systematic Electronic Exchange of Data (SEED) ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës si mjet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet administratës doganore të Kosovës dhe asaj të Serbisë ka filluar më 10 qershor me mbështetjen financiare nga BE-ja.

Planifikimi për vendosjen e pik-kalimeve të përhershme është iniciuar dhe është duke shënuar progres.

**Mosmarrëveshjet për Kadastrin:** Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personave me të drejta legjitime mbi pronën, palët në Dialog janë pajtuar që bashkërisht të themelojnë një kadastër plotësisht të besueshëm në Kosovë. Për këtë qëllim, palët janë pajtuar që BE-ja të përzgjedhë një agjenci teknike të mandatuar për identifikimin e zbrazëtirave të kopjeve të certifikuara nga origjinalet e shënimeve të kadastrës të para viteve 1999 duke e bërë krahasimin e tyre me të dhënat nga kadastra e ri-konstruktuar e Kosovës. Në rastet kur krahasimet tregojnë mospërputhje të të dhënave, një ad-hoc mekanizëm gjykues dy-nivelesh do të jep vendimin përfundimtar se cila e dhënë kadastrës është e saktë. BE-ja do ta mbështes procesin e kopjimit të të dhënave të kadastrës dhe do të sigurojë pajisjet e nevojshme për të dyja palët. Për fillimi e implementimit të këtij procesi autoritetet duhet të vendosin legjislacionin relevant. Në veçanti, draft Ligjin për Agjencinë për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës në Kosovë, e cila e përfshin mandatin e vjetër për kërkesat pronësore të lidhura me konfliktin, dhe mandatin e ri për të dhënat e kadastrës. Ligji duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të ligjit, duhet të sigurohet financimi për AKVPPK.



## COMPACT

### **on Joint Rule of Law Objectives for the period until June 2014**

**The Kosovo Rule of Law Institutions, the Head of the EU Office in Kosovo/EUSR and EULEX Kosovo,**

*Acknowledging* the commitment of the Kosovo rule of law institutions to make further progress towards sustainability and accountability and to develop and strengthen an independent multi-ethnic justice system and a multi-ethnic police and customs service that are free from political interference, respect human rights and adhere to internationally recognized standards and European best practices;

*Reaffirming* their determination to fight serious and organised crime and corruption;

*Affirming* their joint commitment to work within the overall EU policy framework as defined in the Stabilisation and Association Process with Kosovo, including follow-up to the Feasibility Study on a Stabilisation and Association Agreement and the Structured Dialogue on the Rule of Law;

*Committed* to advancing Kosovo's EU perspective by strengthening the ability of Kosovo to align its legislation with the *Acquis Communautaire*;

*Recognising* the need for the Kosovo authorities to effectively cooperate with EULEX Kosovo in order to achieve progress, including on issues covered in the visa liberalisation dialogue;

*Acknowledging* the commitment of the Kosovo rule of law institutions to implement their existing strategies and plans for advancing the rule of law, including the phasing out of EULEX executive mandate to the Kosovo authorities;

*Affirming* the willingness to contribute to a normalization of relations between Pristina and Belgrade and move forward with the implementation of agreements reached so far in the EU facilitated dialogue as well as any other agreement in the rule of law area reached in the future;

*Taking due note* of the full complementarity of the European Union assistance programmes for Kosovo with the overall objectives, concrete goals and specific activities foreseen under this *Compact*;

**have agreed as follows:**

1. The Kosovo institutions, assisted by EULEX Kosovo through the implementation of its mandate of monitoring, mentoring and advising, commit themselves to the following overall **Joint Rule of Law Objectives**:

- Strengthening police, customs, correctional and judicial institutions across the entire territory of Kosovo, including in the north of Kosovo, for the benefit of all communities;
- Increasing the ability of Kosovo's rule of law institutions to deal with inter-ethnic crime, serious and organized crime and corruption;
- Enhancing the anti-corruption capabilities of Kosovo's institutions, particularly through the criminal justice system;
- Enhancing the accountability of all rule of law institutions by allowing institutions such as the Kosovo Judicial Council, the Kosovo Prosecutorial Council and the

Police Inspectorate of Kosovo as well as relevant internal structures to fully assume their roles in accordance with the law;

- Consolidating the strategic, operational and organizational management capacity of Kosovo's rule of law institutions to advance implementation of relevant legislation, strategies and action plans;
- Fostering a higher degree of ethnic inclusion and gender balance in the Kosovo rule of law institutions;
- Improving the responsiveness of Kosovo's rule of law institutions to concerns frequently raised by minorities in relation to public safety, accessibility and openness;
- Strengthening inter-institutional cooperation between prosecutorial bodies and law enforcement by facilitating a higher degree of communication between these institutions;
- Enhancing the ability of the relevant institutions in addressing outstanding property-related claims;
- Further developing of the Kosovo witness protection system;
- Further strengthening mutual legal assistance, including through the use of EULEX Kosovo to facilitate the processing of requests to and from States that have not recognized Kosovo in line with agreed procedures;
- Implementing the agreements reached in the framework of the EU facilitated dialogue, specifically the agreements on Civil Registry Books, Cadastral Records, Freedom of Movement, and Integrated Management of Crossing Points (IBM), and any other agreement in the rule of law area that might be reached in the future.

2. The Head of the EU Office in Kosovo/EUSR, EULEX Kosovo and the Kosovo institutions hereby endorse jointly developed *Compact* Actions which set specific activities and concrete goals with measurable benchmarks in line with the stated overall Joint Rule of Law Objectives.

3. The Joint Rule of Law Coordination Board will regularly review and take stock of progress achieved in the implementation of the *Compact* Actions. The Board will also



assess whether measures in addition to the annexed *Compact* Actions should be adopted to help achieve the stated overall Joint Rule of Law Objectives.

4. This *Compact* will help guide continued rule of law reform efforts in Kosovo and contribute to a strengthened partnership based on common goals and mutual respect.

5. The Kosovo institutions and EULEX Kosovo commit themselves to allocating the necessary resources and focusing their work so as to achieve the goals set out in the *Compact* Actions by June 2014.


**Pristina, the 9 November 2012**

**Deputy Prime  
Minister  
Minister of Justice**




A handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line. The signature is stylized and appears to be 'M. Mustafa'.

**Head of the EU  
Office in  
Kosovo/EUSR**



A handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line. The signature is stylized and appears to be 'J. V. ...'.

**Head of Mission  
EULEX Kosovo**



A handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line. The signature is stylized and appears to be 'A. ...'.